

# Qyteti im

falas



**Investime 2008**  
**Presidenti i Republikës, në Korçë**  
**Risitë e paketës fiskale**



**KORÇA KU**  
**DUA TE JETOJ**



# Presidenti i Republikës, Bamir Topi, në Korçë

**Jam i bindur që Korça sot është në një momentet shumë të rëndësishëm të rivlerësimit të historisë e traditës së saj si dhe projektimit të së ardhmes.**

**Bamir Topi**

Presidenti i Republikës, Bamir Topi, gjatë vizitës në qytetin e Korçës është takuar me përfaqësues të pushtetit vendor, universitetit “Fan.S.Noli” dhe spitalit rajonal “Teni Konomi”.

Ndalesën e parë ai e ka bërë në Bashkinë e qytetit ku është pritur nga Kryetari i Bashkisë, Niko Peleshi, Nënkryetarët, Sotirag Filo dhe Arjan Bejko si dhe një pjesë e stafit bashkiak. Pas fjalës së mirëseardhjes, Presidenti Topi ka vlerësuar progresin e bërë në qytetin tonë në të gjitha çështjet e zhvillimit e veçanërisht në drejtim të rivlerësimit të traditës dhe konservimit të pjesës historike të qytetit. Nuk ka lënë pa përmendur edhe zhvillimet në infrastrukturë e arsimit duke mbështetur dhe projektin e nisur nga Bashkia për ngritjen e një universiteti privat. Ndër të tjera, Presidenti përgëzoi dhe Kryetarin e Bashkisë.

**“Unë dëshiroj t’ju përgëzoj ju z. kryetar për këtë mentalitet modern që ju po shpalosni, vlerësoj angazhimin e kontributin tuaj në krijimin e një klime shumë të mirë në drejtimin e Bashkisë Korçë”**

Ndalesën e dytë Presidenti Topi e ka bërë në Bibliotekën e qytetit ku ka bashkëbiseduar me anëtarët e Këshillit Bashkiak si dhe është njohur me përmirësimet në infrastrukturë dhe funksionet e reja të këtij institucioni.

Më pas Presidenti Topi, vizitoi dhe institucionet e tjera kryesore të qytetit.



## Presidenti Topi dekoron 3 mësues me Urdhërin “Naim Frashëri”

Me propozimin e Bashkisë Korçë, Presidenti i Republikës Bamir Topi, në amfiteatrin e Universitetit “Fan. S. Noli” dekoroi tre mësues të nderuar korçarë.

Mësuesin Pandi Napuçe me Urdhërin “Naim Frashëri” i Artë, me motivacionin: “Për punën shumëvjeçare me përkushtim e pasion, në edukimin e brezave të nxënësve e studentëve dhe progresin e arsimit në vendin tonë”

Mësuesen Drita Mitrushi dhe mësuesin Siri Fazlli me Urdhërin “Naim Frashëri” i Argjentë me motivacionin: “Për punën shumëvjeçare si mësues plot përkushtim, në edukimin e brezave të nxënësve me dashurinë për dijen dhe atdheun”.





## Vizita e Ambasadorit Whithers në Korçë

Ambasadori Amerikan John Whithers zhvilloi një vizitë në qytetin e Korçës ku është pritur nga Kryetari i Bashkisë, Niko Peleshi. Z. Peleshi ka falenderuar qeverinë e SHBA-së për mbështetjen që u ka dhënë mjaft projekteve komunitare përmes Ambasadës Amerikane, por edhe organizmave të tjerë si USAID, Institutit Demokratik Amerikan etj. Ambasadori Amerikan në fjalën e tij ka vlerësuar traditat historike dhe arsimore të qytetit si dhe ka mbështetur ngritjen e një universiteti amerikan në Korçë.

Ambasadori Whithers asistoi edhe në nënshkrimin e marrëveshjes mes Kryebashkiakut Peleshi dhe delegatit të misionit Terre Des Hommes në Shqipëri, Thierry Agajliane për transferimin e TACT, Aksionit Transnacional Kundër Trafikimit të Fëmijëve në Bashki.

“Korça ka një histori të gjatë për shkak të traditave të saj kulturore e arsimore, madje ka një kontribut dhe lidhje të fortë me themelimin e kombit shqiptar. Të gjitha këto i kisha dëgjuar dhe lexuar e më në fund m’u desh që të vija e ta vizitoja vetë qytetin tuaj. Doja të vija sa më parë në Korçë edhe për një arsye tjetër, sepse qyteti nën udhëheqjen tuaj është duke ndërmarrë një sërë projektesh themelore e të rëndësishme për jetën e qytetit”

**John Whithers**



## Objekte që do të financohen nga Bashkia gjatë këtij viti:

OBJEKTI	FONDI I OBJEKTIT ( NË LEKË)
Ndërtim i Zonës këmbësore	35 000 000
Sistemim në Lagjet 1 e 2	18 000 000
Studime e projektme	7 000 000
Tabela treguese	800 000
Blerje e koshave të vegjël	3 500 000
Rikonstruksion i shtëpisë rumune	7 000 000
Rikonstruksion i ambienteve të Bashkisë Korçë (shitesë)	466 080

### Investime në vazhdim:

- ➔ Sistemim-asfaltimi tek Blloku i Banesave Kolektive, Lagjia 9
- ➔ Sistemim-asfaltimi tek Rruga "1-Maji" e Blloku i Banesave në Lagjen 9
- ➔ Sistemim-asfaltim Rruga "Riza Cerova" e "Viktimat e Borovës"
- ➔ Sistemim-asfaltimi tek Rruga "Xhafer C. Lubonja"
- ➔ Sistemim-asfaltim, Rruga "Ismail Latifllari"



Ndërkohë, po gjatë këtij viti do të marrin udhë një sërë projektsh të rëndësishme, të cilat do të përmirësojnë imazhin e qytetit si dhe do të lehtësojnë jetën e qytetarëve. Në përcaktimin e këtyre prioriteteve janë marrë parasysh nevojat e qytetarëve të identifikuar gjatë procesit të Buxhetimit me Pjesëmarrje e ndërmarrë nga Bashkia gjatë muajit shtator të vitit të kaluar. Krahas sistemimit e shtrimit të rrugëve dhe blerje koshash për një Korçë më të pastër, në këto projekte zenë vend ndërtimi i zonës këmbësore, rikonstruksioni i shtëpisë rumune dhe kthimi i saj në qendër me profil kulturor etj.



Gjatë vitit 2008 Bashkia gjatë 2007-ës që konsis

# Investime 2008

Korçë do të vazhdojë investimet publike të nisura  
të cilat kryesisht në sistemime e asfaltime rrugësh.



# Shtohen

Pyllëzimi, një traditë e harruar prej vitesh, por mjaft e rëndësishme për mjedisin është ringjallur nëpërmjet një aksioni të zhvilluar nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike. 900 fidanë akacie dhe pisha dekorativë janë mbjellë tek kodrat e qytetit. Përveç tyre, puna

ka vazhduar në gjelbërimin dhe sistemimin e parqeve dhe lulishteve të qytetit. Nuk janë lënë jashtë vëmendjes edhe zonat periferike si Unaza e qytetit, tek Lumi i Drenicës, përgjatë rrugës “Partizani”, “Xhamia e Re” si dhe në shkollat e qytetit.



Së bashku për një qytet më të gjelbër



Në të dy krahët e rrugës “Nevruz Nure” , e cila është një rrugë periferike e Lagjes 17, janë mbjellë 14 rrënjë pemë. Ka qenë kjo nisma e Bankës Popullore “Një punonjës një pemë”, pjesë e programeve të saj sociale, e cila në bashkëpunim me Bashkinë Korçë ka gjelbëruar e dekoruar këtë rrugë periferike deri dje të zhveshur e duke i dhënë asaj një fytyrë më të urbanizuar.

Në këtë mënyrë Banka Popullore është bërë partnere duke hedhur hapin e parë në mbështetje të programeve të Bashkisë Korçë në drejtim të shtimit të sipërfaqeve të gjelbra.

**Aurel Melonashi, Drejtor i kësaj banke për Korçën,** është shprehur se edhe në të ardhmen do t'i bashkohet programeve të Bashkisë duke financuar pjesërisht apo plotësisht projektet e saj.

# sipërfaqet e gjelbra



## Rregullorja e re e pastrimit të qytetit

Miratohet Rregullorja e re e Administrimit të Mbetjeve Urbane dhe Pastrimit të Qytetit. Objekti kryesor i saj është përmirësimi i bazës ligjore si dhe optimizimi i shërbimit të pastrimit dhe grumbullimit të mbetjeve.

Kjo rregullore është një instrument qytetarie dhe transparence që përmbledh njëherësh në një dokument të vetëm rregullat dhe detyrimet, që gjithsecili prej nesh duhet të ketë parasysht për të respektuar ambientin ku jetojmë dhe përmirësuar cilësinë e jetesës.

Rregullorja do t'i paraprijë implementimit të Projektit të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta të Shqipërisë Juglindore e cila do të sjellë një menaxhim modern të mbetjeve nëpërmjet ndërtimit të landfillit sanitar.

# Çfarë po përgatit Bashkia në kuadrin e programit

## “Qyteti social”



### Qendër komunitare për të moshuarit



Kjo qendër do të ofrojë shërbime psiko-sociale, mjekësore, kulturore e argëtuese me qëllim zbutjen e problemeve të moshës së tretë, shmangien e izolimit social, sigurimin e mirëqënies psikologjike të të moshuarve etj. Gjithashtu, të moshuarve do t'u ofrohet kafe, çaj falas dhe do të kenë mundësinë të lexojnë shtypin e përditshëm, të argëtohen me lojra tavoline, të ndjekin lajmet dhe emisionet e ndryshme etj.

### → Mjete shkollore për fëmijët jetimë

Projekti synon integrimin e fëmijëve jetimë në jetën shkollore. Përfitues të këtij projekti do të jenë 155 fëmijë jetimë, të cilët do të kenë mundësinë e një vijueshmërie të kënaqshme në procesin mësimor.

### → Krijimi i një qendre për grumbullimin e veshjeve të mirëmbajtura, të përdorura

Me këtë iniciativë të re Bashkia do të mbështesë hapjen e një qendre për grumbullimin e veshjeve të mirëmbajtura, të përdorura, të cilat do t'u shpërndahen familjeve të varfra në qytet duke u dhënë mundësi në këtë mënyrë edhe qytetarëve korçarë të japin kontributin e tyre për shtresat në nevojë.




## Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve

Programi TACT (Aksioni Transnacional Kundër Trafikimit të Fëmijëve) punon për ngritjen e një sistemi të mbrojtjes së fëmijëve, në 5 rajone të Shqipërisë. Në luftë kundër trafikimit të fëmijëve, TACT ndihmon zhvillimin komunitar dhe integrimin e familjeve dhe fëmijëve në rrezik trafikimi. TACT, tashmë i traansferuar në bashki pas marrëveshjes së nënshkruar mes Bashkisë dhe organizatës Terre des Hommes do të finalizojë ngritjen e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve ku Bashkia si lider kryesor do të koordinojë këtë sistem në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë Arsimore dhe organizatat komunitare.

Këshilli i Bashkisë Korçë, gjatë 2008-ës miratoi fondin prej 1 milion e 200 mijë Euro, fond i cili do të vihet në dispozicion të strehimit për ndërtimin e 2 pallateve me 96 apartamente banimi. Gjatë këtij viti, apartamentet e banimit do të ndërtohen sipas kriterit “Banesa sociale me qera”.


Aktualisht nga Zyra e Urbanistikës në Bashki po punohet për sheshin e ndërtimit tek Deboja (Varrezat e Francezëve). Fondi për ndërtimin e këtyre banesave është siguruar nga Banka Europiane për Zhvillim dhe është pjesë e projektit të Qeverisë Shqiptare për ndërtimin e banesave sociale me qera në 8 qytete të Shqipërisë, ndër të cilat është përzgjedhur edhe Bashkia e Korçës. Në ndryshim nga viti i kaluar këto banesa do t'i përfitojnë familjet me të ardhura më të pakta.



# Risitë e paketës fiskale 2008

Kushte lehtësuese për bizneset e reja dhe studentët

- ➔ Tarifa 0 (zero) e regjistrimit (leja e ushtrimit të aktivitetit) për kategoritë: artizanat, teknologjitë e informacionit, edukim, argëtim.
- ➔ Studentët të cilët janë diplomuar në vitin 2007 dhe gjatë vitit 2008, që do të hapin një aktivitet biznesi i vogël në territorin e Bashkisë Korçë, do të paguajnë 30% më pak të taksës vendore të biznesit të vogël.
- ➔ Subjektet e biznesit të vogël si bare, restorante, internet kafe, butik dhe laborator fotografik, që bëhen pjesë e projektit PRO STUDENT, për vitin ushtrimor 2008 do të paguajnë 20% më pak të taksës vendore të biznesit të vogël.
- ➔ Subjektet e biznesit të vogël që do të paguajnë të plotë vlerën e detyrimit për taksën vendore për vitin në vazhdim brenda datës 31 Mars, do të paguajnë 5% më pak të taksës vendore të biznesit të vogël.
- ➔ Nivele të diferencuara të taksës së ndikimit në infrastrukturë (taksa e ndërtimeve të reja) bazuar gjendjen e rritit inxhinierik sipas zonifikimit A,B,C.
- ➔ Për çdo lloj ndërtese, që do të plotësojë kërkesat e programit të Bashkisë Korçë për rritjen e efikasitetit të energjisë (termoizolim), niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë do të jetë 1% për të tre zonat e lartpërmendura.



## Pazari i vjetër i Korçës do të restaurohet dhe rivitalizohet

Pazari i vjetër i Korçës, i cili mban statusin e Monumentit të Kulturës është përzgjedhur si i vetmi projekt nga e gjithë Shqipëria për t'u prezantuar në Konferencën e Donatorëve në Verona. Nëpërmjet kësaj konference, e cila organizohet nga Këshilli i Europës, Bashkia Korçë synon të gjejë investitorë për t'i kthyer sharmin e humbur kësaj pjese historike me vlera të padiskutueshme arkitektonike të qytetit tonë. Pazari parashikohet të shndërrohet në një qendër tregëtare me interes për zhvillimin ekonomik dhe njëkohësisht qendër të rëndësishme atraksioni turistik.



## 2008-a, viti i projekteve të rëndësishme për urbanistikën e qytetit

Në mbledhjen e parë të Këshillit të Rregullimit të Territorit (KRRT), Kryetari i Bashkisë Korçë, Niko Peleshi, e ka shpallur vitin 2008, vitin kundër ndërtimeve të jashtëligjshme. Decentralizimi i pushtetit vendor dhe kalimi i Inspektoriatit Ndërtimor dhe Urbanistik në varësi të Bashkisë i kanë dhënë asaj të drejtën dhe fuqinë për të administruar më mirë ndërtimet në qytet duke u prerë rrugën atyre pa lejë.

Njëkohësisht viti 2008 merr një rëndësi të veçantë pasi do të realizojë Planin Rregullues që do të hartohet mbi bazën e Detyrës së Projektimit, një bashkëpunim ky i Bashkisë me aktorë të tjerë. Për më tepër do të punohet për përmirësimin e rregullores së Ansambllit Arkitektonik Urbanistik Tradicional dhe Qendrës Historike.





# Muzeu i ri i Artit Mesjetar

Fillon ndërtimi i kompleksit të ri muzeal të artit mesjetar. Muzeu i Artit Mesjetar në Korçë është një ndër objektet më të rëndësishme historike e kulturore, jo vetëm për Korçën e Shqipërinë, por edhe më gjerë. Ai është një muze kombëtar, një nga më të mëdhenjtë në Europë përsa i përket artit bizantin, me një fond prej 7000 objektesh mes të cilave ikona, punime ne gur, dru, ar, skulptura etj, më vizitueshmi nga turistët vendas e të huaj.

Ndërtimi i këtij muzeu është pjesë e projekteve dhe vizionit të Bashkisë Korçë në drejtim të zhvillimit të turizmit kulturor. Krahas sallave dhe galerive të ekspozimit muzeu do të përmbajë edhe ambiente e laboratorë për punën shkencore e restauruese. Ndërtimi i kësaj qendre muzeale është investim i qeverisë greke nëpërmjet Programit Hellenik AID përmes Konsullatës Greke në Korçë i cili shkon në 480 mijë euro.



# Prishen ndërtimet pa lejë

Inspektoriati Ndërtimor dhe Urbanistik i Bashkisë ka prishur objektet e paligjshme dhe rrethimet në Bllokun e Banesave Kolektive, Lagjia 13, ku Bashkia po investon për sistemimin dhe asfaltimin e rrugës dhe krijimin e sipërfaqeve të gjelbra në këtë zonë.

Aktualisht Bashkia është duke përpunuar hartën elektronike, e cila do të lehtësojë identifikimin e objekteve të paligjshme që do të prishen gradualisht, duke u dhënë prioritet atyre zonave në të cilat ajo do të investojë.



## Cila është zanafilla e emrit të qytetit



**HIPOTEZA E PARË:** Krahina e Korçës ra nën sundimin e perandorit bullgar Boriz në vitin 853. Ai formoi në këtë zonë njësinë administrative të emërtuar “Kutmicevicë”, që në shqip do të thotë “Tokë e porsa pushtuar”. Forcat bullgare qëndruan në zonën tonë deri në vitin 1018, vit kur u larguan në shtetet e tjera të Ballkanit për të vazhduar pushtimet. Fjala “Korçë”, në sllavisht do të thotë “Dardhë e egër” (ose Goricë). Këtë emër qytetit tonë ia vunë bullgarët para vitit 1018. Edhe sot në disa gjuhë të ndryshme, emri i qytetit tonë shqiptohet në formën “Coritza” (Kórizá).

e tjera të Ballkanit për të vazhduar pushtimet. Fjala “Korçë”, në sllavisht do të thotë “Dardhë e egër” (ose Goricë). Këtë emër qytetit tonë ia vunë bullgarët para vitit 1018. Edhe sot në disa gjuhë të ndryshme, emri i qytetit tonë shqiptohet në formën “Coritza” (Kórizá).

**HIPOTEZA E DYTË:** Nga regjistri i Korçës e i Përmetit i kryer në vitin 1431-1432 fill mbas pushtimit osman del se krahina

e Korçës u përfshi në një vilajet me qendër në Korçë, të cilën turqit e quajtën “Gjorixhe”. Vetë Korça figuron si kështjellë e banuar me 26 shtëpi.

### Mbi themelimin e Korçës

Për të ndriçuar plotësisht lashtësinë dhe zanafillën e Korçës dëshmitë arkeologjike dhe dokumentet historike janë të mangëta. Gjetjet e rastit, të zbuluara në kodrat Partizani dhe në dalje të qytetit në anën juglindore, që si kohë i përkasin antikitetit të vonë, dëshmojnë për ekzistencën e një qendre të banuar. Njoftimi më i hershëm i shkruar mbi ekzistencën e qytetit të Korçës vjen nga kronika mbi historinë dhe gjeneologjinë e familjes së madhe feudale shqiptare të Muzakajve, shkruar nga Gjon Muzaka me 1510. Shkruesi kur numëron zotërimet e Andre Muzakës i cili arriti titullin Sebastokrator më 1280-1281 dhe u bë zot i një

krahine të gjërë që shtrihej në të gjithë Shqipërinë Qendrore deri në lumin Vjosë në jug, me kryeqendër Beratin dhe që përfshinte ndërmjet të tjerave Myzeqenë, Tomoricën, Oparin, Devollin, Kosturin, përmend dhe Korçën, të cilën e cilëson qytet.

Vendosja nga turqit e qendrës së krahinës në Korçë nuk është e rastësishme. Këtu ata gjetën një qendër tashmë të formuar e të rëndësishme ekonomike, në një pozitë të favorshme, me kala e pazar dhe me ekonomi të fuqishme pranë, siç ishin fshatrat Mborje e Peshkopi. Mborja ndodhej 3 km në juglindje, e cila ishte nën zotërimin e Subashit të Korçës dhe Peshkopia si timar i kadiut të Korçës. Mborja numëronte 70 shtëpi e në mes të fshatit ngrihej një kishë e vjetër, e ndërtuar më 1389, ndërsa në malin mbi fshat një kala e vogël mesjetare. Mborja në fillim të shek.XV ishte një qendër e ndonjë feudali të vogël vendas, me kala, kishë e treg. Fshati Peshkopi numëronte rreth 71 shtëpi. Fundi i shek. XV shënon një moment të rëndësishëm në historinë e Korçës. Në këtë kohë sulltan Bajaziti II i dhuron Mirahor Iliaz beut, për merita shërbimi, fshatin Peshkopi për ta përdorur si pronë vetiake – mylyk.

...vazhdon në numrin e ardhshëm




# Burime:

## LIBRAT:

- “Fjalori enciklopedik shqiptar”, Tiranë, 1985
- “Korça, në faqet e historisë”, Emin Selenica
- “Një faqe historike”, Nikollaq Zoi, Korçë, 2000
- “Korça - urbanistika, arkitektura”, Piro Thomo
- “Mbi themelimin e Korçës” (broshurë), Arben Gjata
- “Shqipëria më 1928”, Teki Selenica, Tiranë, 1928
- “Shqipëria e ilustruar më 1928”, Teki Selenica, Tiranë, 1928
- “Korça dhe fshatrat përçark”, Nuçi Naçi, Sofje, 1901
- “Korça dhe katundet e çarkut” (ribotim i plotësuar), Nuçi Naçi, Korçë, 1923
- “Historia e Shqipërisë” vëll. II, Tiranë 1965
- “Themistokli Gërmenji”, Piro Tako, Tiranë, 1988

## GAZETAT:

- (Koleksione pranë Bibliotekës “Thimi Mitko” dhe Bibliotekës Kombëtare Tiranë)
- “Korça” drejtuar nga Sami Pojani e Lytfi Zavalani, Korçë, 1908-1910
  - “Lidhja othodokse”, drejtuar nga Mihal Grameno, Korçë, 1909
  - “Koha” drejtuar nga Mihal, Mina e Koço Grameno, Korçë, 1911-1926
  - “E drejta”, drejtuar nga Leonidha Naçi, Korçë, 1924
  - “Gazeta e Korçës”, drejtuar nga Zhan Gorguzi. Koleksion i viteve 1930-1935



# → Projekt - Ide 2008

Ne nuk mundemi të realizojmë të vetëm misionin tonë për një qytet më të mirë



Për zhvillimin e programeve të saj, Bashkia Korçë kërkon partneritetin e aktorëve lokalë. Në një takim të zhvilluar me drejtuesit e bankave, institucioneve kryesore në qytet si dhe organizatat joqeveritare, janë prezantuar projekt-idetë e Bashkisë sipas programeve të saj për vitin 2008: Qyteti social; Qyteti për fëmijët; Qyteti mbështet të rinjtë; Bashkia për qytetarët; Korca, shpirti i traditës; Sport për të gjithë; e-City. Padyshim Bashkia është institucioni kryesor i qytetit, përgjegjës për projektet e zhvillimit e për t'i dhënë qytetit tonë atë vizion që e bën të prosperojë, vizion të cilin ne do ta zhvillojmë në bashkëpunim me një rrjet partnerësh të qëndrueshëm.

## Bashkia Korçë e përzgjedhura e USAID në Programin e Qeverisjes Vendore



→ Bashkia e Korçës është një nga 10 Bashkitë e Përzgjedhura nga USAID në kuadër të Programit për Qeverisjen Vendore, që synon mbështetjen e ekonomisë vendore, përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet pjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe sektorit privat. Ky program do të sigurojë mbështetje teknike dhe trajnim për stafin e bashkisë në shumë çështje përfshirë mbledhjen e taksave, menaxhimin e aseteve, buxhetimin, huamarrjen dhe shpërndarjen e shërbimeve. Në takimet e zhvilluara në datat 28 dhe 29 Shkurt u krijua Komiteti për Zhvillimin Ekonomik, u përcaktuan prioritetet për zhvillimin lokal si dhe u diskutuan hapat konkretë që do të ndërmerren për realizimin e tyre.

# Supplement

Pandi →  
Napuçe tek  
“Qyteti im”



# Ai shtet që nuk e vlerëson figurën e mësuesit, deformon fytyrën e vet

Pandi Napuçe ka lindur në Korçë në vitin 1941. Është diplomuar në Universitetin e Tiranës, dega Matematikë. Ka punuar si mësues në gjimnazin e Maliqit si dhe në Shkollën e Mesme të Përgjithshme "Raqi Qirinxi". Për disa vjet ka qenë metodist në kabinetin pedagogjik dhe ka qenë drejtor i këtij kabineti në periudhën 1990 – 1992.

Pandi Napuçe është Dekani i parë i Fakultetit të Mësuesisë pranë Universitetit "Fan S. Noli" Korçë dhe një nga theme-luesit e parë të tij. Aktualisht është pedagog pranë këtij Universiteti.

Gjatë punës së tij ka merituar gradat shkencore: Kandidat i Shkencave – 1982, Doktor i Shkencave – 1994, si edhe titujt: Urdhërin "Naim Frashëri" – 1989, Mësues i Merituar – 1993 dhe së fundmi është dekoruar nga Presidenti i Republikës me medaljen e artë "Naim Frashëri".

Instituti Amerikan i Biografive i ka dhënë titujt: Njeriu i Vitit në 1998 dhe Njeriu i Shekullit të 20-të.

Është kualifikuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Greqi, Maqedoni, Angli, etj. Është anëtar i Senatit të Universitetit që nga fillimi i tij.



**Pandi Napuce:** Në përgjigje të pyetjes suaj dua të them diçka që e kam mësuar shumë vonë – Aleksandri i Madh i Maqedonisë, kur e kanë pyetur se pse e do më shumë mësuesin tënd Aristotelin se babain tënd Filipin, u përgjigj: "Babai më ka sjellë në jetë, mësuesi më ka ngritur në qiell". Po të isha edhe një herë i ri do të rizgjidhja përsëri të bëja profesionin e mësuesit.

**Qyteti im:** Keni punuar në kohë të ndryshme dhe në cikle të ndryshme të arsimit. Si e vlerësoni arsimin sot? Çfarë ka humbur dhe çfarë ka fituar arsimi në këto vite ndryshimesh të mëdha?

**Pandi Napuce:** Mendoj se sot dija është shumëdimensionale pasi edhe mundësitë e të nxënimit janë të shumta. Programet gjithashtu kanë pësuar një ndryshim shumë cilësor, por figura e mësuesit duhet të vlerësohet më shumë. Në parathenien e një teksti mësimor të viteve '70 shkruhej: "Ai shtet që nuk e vlerëson figurën e mësuesit deformon fytyrën e vet".

**Qyteti im:** Çfarë i duhet në fakt një mësuesi për të fituar respektin?

**Pandi Napuce:** Së pari mësuesi duhet të jetë shumë i përgatitur. Nxënësit janë intuitivë, ata të gjithë janë në gjendje të dallojnë pasigurinë e mësuesit. Së dyti, vlen mjeshtëria e mësimdhënies, pasioni. Së treti, mësuesi duhet të jetë njeri i drejtë dhe i thjeshtë.

**Qyteti im:** Vlerësimi që ju bë nga Presidenti Bamir Topi, ishte një nder jo vetëm për ju, por edhe për Korçën. Keni marrë shumë vlerësime në jetë, por çfarë do të thotë për ju ky i fundit?

**Pandi Napuce:** Për mua ky vlerësim është i një rëndësie të veçantë. Sot e ndiej veten shumë të lumtur. Ky vlerësim nuk më bëhet vetëm mua, por gjithë plejadës së mësuesve, të cilët kanë punuar në të njëjtën kohë me mua. Kënaqësia më e madhe është se nxënësit që ne kemi edukuar janë ambasadorë të mirëpritur në vendet ku jetojnë dhe punojnë.

**Qyteti im:** Pas kaq vitesh pune si mësues, pedagog, drejtues i institucioneve arsimore a do të donit të kishit një profesion tjetër?



**Qyteti im: Sa dëmtues ka qenë fenomeni i rrjedhjes së trurit për Korçën dhe zhvillimet e saj të ardhshme?**

**Pandi Napuce:** Korça është boshatisur sidomos nga figura profesionistësh, njerëz me origjinë familjare kulturore, të cilët i kanë krijuar realisht Korçës një boshllëk.

**Qyteti im: Pse i largohen këta njerëz Korçës profesor?**

**Pandi Napuce:** Sipas mendimit tim, arsyeja më kryesore është joshja nga një standart më i lartë ekonomik që ofrojnë vendet e tjera. Viti i mbrapshtë 1997 ka qenë fatal për Korçën. Ai vit shkatërroi besimin e njerëzve dhe kjo nxiti iniciativën e shumë personave edhe në moshë të kaluarë për të braktisur Korçën.


**Qyteti im: A është e “ndreqshme” kjo rredhje? Si e shihni në fokusin tuaj perspektivën e këtij qyteti që ka qenë elitare që nga koha kur quhej “Paris i Vogël” e ka vazhduar të jetë i tillë përsa i takon prodhimit cilësor dhe sasior të kuadrove në fusha të ndryshme të jetës?**

**A do të vazhdojë të jetë Korça qytet elitare?**

**Pandi Napuce:** Unë mendoj se nuk mund të çrrënjohet dot nga tradita e një qyteti kultura. Njerëzit mund të zhvendosen, por kultura mbetet për një kohë të gjatë. Korça edhe sot është elitare. Korça është një qytet i qetë, të gjithë të huajt që kanë ardhur këtu dhe me të cilët unë kam pasur kontakte, thonë se në Korçë shohim një rini të bukur, të pastër, njerëz të qetë, shtëpi të bukura me lule. Këtu ekziston një qytetari e vërtetë. Korça ka pësuar thjesht një stepje. Unë kam besim të plotë se do të ketë ndryshime graduale, por të besueshme. Korça shumë shpejt do të plotësojë boshllëkun e krijuar nga largimi i shumë njerëzve prej saj.

**Qyteti im: Korça është qytet i arsimit. Nuk kam parasysh këtu vetëm Mësonjëtorën e Parë Shqipe të vitit 1887, apo Universitetin “Fan S.Noli”, por edhe një vizion të Bashkisë për shndërrimin e Korçës në një qytet universitar. Sa e rëndësishme është nëse universitete të tjera private, ose publike do të hapen?**

**Pandi Napuce:** Kultura dhe arsimit janë barometri kryesor i zhvillimit të një qyteti. Qytetet zhvillohen mbi bazën e parimit të enëve komunikuese. Një qytet me kulturë e arsim të zhvilluar detyrimisht do të rrisë edhe standartet e veta ekonomike. Ky është një parim shkencor. Sa më shumë kulturë aq më shumë progres. Korça në një të ardhme të afërt do të ketë vendin që meriton.





## Ju duam shumë!

“Ju duam shumë!”, ishte mesazhi i Bashkisë përcjellë në Ditën Ndërkombëtare të Gruas. Të rinjtë e Senatit Rinor, të shpërndarë në bulevardet e sheshet kryesore të qytetit, së bashku me urimin e festës u kanë dhuruar grave korçare 350 karafila, duke sjellë në kujtesën e të gjithëve faktin se gratë janë një pjesë e rëndësishme dhe vitale e shoqërisë sonë.


Ky aktivitet ishte një bashkëpunim i Bashkisë Korçë, Pro Credit Bank dhe Senatit Rinor.

## Panairi për shëndetin e gruas

Nëpërmjet një aktiviteti shumë kompleks të organizuar në Qendrën Kulturore “V. Mio”, Bashkia Korçë në bashkëpunim me “CSDC”, Qendrën e Kujdesit Paliativ dhe Drejtorinë e Shërbimit Publik, përcolli mesazhin e dashurisë dhe vlerësimit për gruan. Pjesët muzikore të interpretuara nga shkolla e muzikës “Tefta Tashko Koço”, dhe serenatistët, informacionet e vlefshme mbi shëndetin e gruas të prezantuara nga mjekë të njohur, copëzat skenike nga Teatri Shëtitës si dhe ekspozita me punime artistike dhe artizanale u ndoqën me interes nga të pranishmit.

Bashkëpunuan: CSDC, PCV, Gruaja Korçare, D.SH.P, D.SH.S, Q. E kujdesit Paliativ, TV Lobi, Magic Star, Nëna, fëmijët e ardhmja, Shkolla e Muzikës, Grand Hotel, AASK





## TUMA ILIRE E KAMENICËS, ekspozohet skeleti i gruas me fetusin e foshnjës 9-muajshe

Në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, Tuma ilire e Kamenicës u bë një vendtakim i rëndësishëm mes grave të sotme dhe atyre prehistorike. Një kuptim të veçantë i dha kësaj dite ekspozimi për herë të parë i skeletit të gruas me fetusin e foshnjës 9 -muajshe, që daton në shek. II p.s.

Në simpoziumin shkencor të organizuar nga kjo qendër arkeologjiko- muzeale, u fokusua roli i gruas shqiptare gjatë shekujve e veçanërisht roli i atyre që kanë lënë gjurmë në histori duke evokuar figura të tilla si Sevasti e Parashqevi Qiriaz. Simpoziumi shkencor, në të cilin asistoi edhe znj. Andromaqi Gjergji, e vetmja anëtare femër e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë u ndoq me interes nga drejtuesit e pushtetit lokal, institucioneve të ndryshme e të apasionuar pas arkeologjisë.

## Vali & Tini - komedi në ditën e të dashuruarve

Trupa e estradës së Korçës, në ditën e Shën Valentinit, festës së të dashuruarve, ka vënë në skenë spektaklin e titulluar “Vali & Tini”, me libret dhe regji të Erand Sojli dhe me pjesëmarrjen ekskluzive të aktorëve të mirënjohur të humorit Salsano Rapi, Gazmend Paja e Erjona Kakeli.

Tema e dashurisë e përcjellë nëpërmjet një vajze me probleme mendore, rrjedhë e një dashurie të pamundur, përçoi mesazhin: “Rruga më e gjatë në botë është nga mendja në zemër, sepse të mençur ka shumë, por me shpirt ka shumë, shumë pak...”

Në skenë, krahas aktorëve korçarë të humorit Zamira Kita e Albano Prodani kënduan Laxarela dhe vëllezërit Stefan e Endri Prifti të shoqëruar nga interpretimi “live” i orkestrës së pallatit të Kulturës “V.Mio” nën drejtimin e Adrian Jorgjit.

Shfaqja është ndjekur me interes nga publiku, i cili për katër ditë me rradhe ka mbushur sallën e Teatrit “A.Z.Çajupi”.





EMBLEMA E NEKRIT  
"GZETIA E SHQIPËS"  
E VITIT 1910

## Koleksionet e rralla të arsimit

Në ditën e 7 Marsit, e cila përkon me 121 vjetorin e Mësonjëtores së Parë Shqipe, Bashkia Korçë në bashkëpunim me Senatin Rinor dhe Qendrën Mbarëkombëtare të Koleksionistëve Shqiptarë, organizoi çeljen e ekspozitës me koleksione të rralla të botimeve për shkollat e para shqipe.

Ekspozita është çelur pranë Muzeut të Arsimit Kombëtar Korçë dhe është vizituar nga vendas e të huaj. Me interes ishin ekspozimi i objekteve të rralla të konservuara nga Shpëtim Sala, Kryetar i Qendrës Mbarëkombëtare të Koleksionistëve Shqiptarë dhe koleksionistëve të tjerë të ardhur enkas nga Tirana si Vangjo Ilo, Ilir Dojka, Emona Metalia si dhe Niko Kotherja i cili është edhe Kryetar i Senatit Rinor pranë Bashkisë Korçë.



“Ky është një rast që vjen shumë rrallë në histori. E quaj veten fatlum që sot të përcjell në emër të gjithë qytetarëve të Korçës urimet më të mira për pavarësinë e Kosovës, pjesës tjetër të kombit shqiptar, vëllezërve tanë”.

**Niko Peleshi**



## Kosova, shteti më i ri i Europës

➡ Më 17 shkurt Kosova shpall pavarësinë. Ka lindur në këtë mënyrë shteti më i ri i Europës si rezultat i përpjekjeve të mëdha të forcave të brendshme demokratike e patriotike dhe ndihmës së faktorit ndërkombëtar.

➡ Ashtu si për miliona shqiptarë në festë, ngjarja historike është celebruar edhe në Korçë. Duke filluar qysh ditën e shtunë banda e qytetit nëpërmjet marsheve të gëzuara i ka paraprirë festimeve të së dielës ku në mesditë është ngritur flamuri, simbol i lirisë e pavarësisë. Më tej Kryetari i Bashkisë Niko Peleshi dhe Prefektja e Qarkut Korçë Elfrida Zefi kanë kënduar së bashku me Korin “Lira” këngët patriotike.

## → Struktura e re e Bashkisë me funksione të ndara

Me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Niko Peleshi, Këshilli Bashkiak miratoi strukturën e re të organizimit të administratës së Bashkisë Korçë. Parimi bazë i strukturës i kësaj strukture është ndarja e funksioneve drejtuese në politika zhvillimi dhe planifikim-projektimi, kontroll i zhvillimit dhe i territorit, menaxhimi i kontratave dhe projekteve dhe ndarja

e katërt funksionale shërbime mbështetëse për punën e Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë. Nëpërmjet këtij ndryshimi synohet të rritet efienca duke përmirësuar cilësinë dhe të minimizohet mundësia e abuzimit me detyrën, nëpërmjet eliminimit të cikleve të mbyllura.



- Këshilli Bashkiak
- Kryetari i Bashkisë
- Kabineti i Kryetarit
- Sektori i Administrimit të Rajoneve
- Sektori i Prokurimeve
- Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun
- Drejtoria e Informimit Qytetar
- Drejtoria e Auditimit të Brendshëm

- Drejtoria e Politikave të Zhvillimit, Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit me Donatorët
- Drejtoria e Planifikimit Hapësinor dhe Projekteve

- Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit Urban
- Drejtoria e Kontrollit të Territorit
- Inspektorati Ndërtimor Urbanistik

- Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave
- Drejtoria e Përkrahjes Sociale dhe Strehimit
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Marketingut të qytetit dhe Turizmit

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Protokoll-Arkivës dhe Mbështetjes
- Drejtoria Juridike
- Drejtoria e Financës
- Drejtoria e të Ardhurave

# Korça ku → dua të jetoj

## Të jesh krenar për qytetin tënd!

Nëse jeni një i apasionuar pas fotografisë, kjo është mundësia jote. Dërgo foto të qytetit që të bën ty të ndihesh krenar për të.

Ne ju ftojmë të gjithëve të dërgoni foto nga ndërtesat, aktivitetet, festat apo çdo gjë tjetër që ju e keni përzemër, apo ju pëlqen ta shihni.

Çdo muaj, fotot më të mira do të publikohen në faqet e "Qyteti im" dhe në fund të vitit, ju do të keni mundësi të paraqisni punën tuaj në një ekspozitë enkas për ju, ku do të zgjidhet fotoja e vitit.

### Kontakte:

Tel: 45755

e-mail: bashkiko@albmail.com

Bashkë me fotot dërgoni dhe një përshkrim të shkurtër të fotos dhe pse e keni zgjedhur pikërisht atë.



# Fjalën

# e ke ti!

Komplimenta    Komente    Ankesa

Bashkia të ofron mundësinë të thuash atë që ti mendon mbi shërbimet e ofruara prej saj, sa pranë nevojave tuaja qëndrojnë ato dhe çfarë do të donit të bëhej më mire!

Ju mund të dërgoni **KOMPLIMENTE**,  
**KOMENTE** apo **ANKESA**

Ne kemi marrë përsipër t' ju sigurojmë shërbime sa më cilësore. Për këtë na duhet mendimi juaj. Nëse kemi bërë një punë të mirë apo jo, ne duam ta dëgjojmë këtë nga ju.

Fjalën e ke ti!

Tel: 45755

e-mail: bashkiko@albmail.com

Dorëzoni formatin e plotësuar pranë Zyrës së Informacionit "Bashkia Korçë"

Jepni sa më shumë informacion

.....  
.....  
.....  
.....  
.....  
.....  
.....  
.....  
.....  
.....  
.....

**Të dhënat tuaja (jo e detyrueshme)**

Emër Mbiemër: .....

Profesioni: .....

Adresa: .....

Tel: .....

e-mail: .....

**Zgjidhni opsionin**

- Komplimenta**  
 **Komente**  
 **Ankesa**



**Përgatitën:**

Ana Qeramixhi  
Sofjola Kotelli  
Mikel Llogori

**Suplement**

Benila Tërova

**Ndihmuan:**

Stafi i Bashkisë Korçë  
Pallati i Kulturës “V.Mio”  
Ndërmarja e Shërbimeve Publike  
Teatri “A.Z.Çajupi”

**Suporti teknik**

Andi Furxhi

**Fotot nga:**

Ana Qeramixhi  
Donald Braholli  
Vaskë Niço

**Design:**

R&T Advertising



Për një qytet ku bashkëjeton tradita me modernen, ku të rinjtë realizojnë aspiratat e tyre për shkollim dhe punësim, ku të moshuarit jetojnë ditë të bardha, një qytet që ka gjithmonë një dorë të zgjatur për të nxjerrë nga vështirësia dhe ku problemi yt gjen një zgjidhje.

Pas një kthese ecim me vrull në një drejtim të ri për të kapur kohën e humbur dhe për të dalë në krye siç i ka hije Korçës. Ky është identiteti ynë i ri.

# Mbështesni revistën “Qyteti Im”



Për më tepër informacion:

Tel: 457-55

e-mail: bashkiko@albmail.com